



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

EFEKTI ESTETIK I SHEMBËLLTYRAVE LETRARE NË LIGJËRIMIN GOJOR

Hajri Mandri*

**Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes,*

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University Tiranë, Albania

Abstrakt

Përdorimi i shembëlltyrave letrare, (parabola), në ligjërimin gojor nuk është vetëm një art, por është edhe një lloj magjie që transformon fjalët e thjeshta në një udhëtim plot kuptim dhe bukuri. Një histori të vogël që mbart një mesazh të thellë, të tillë që të bën të mendosh dhe të ndjehesh si një zbulues i një të panjohure të madhe. Kjo është fuqia e shembëlltyrës! Në kontekstin e ligjëritit gojor, shembëlltyrat (dhe figurat e tjera stilistike) luajnë një rol të dyfishtë.

Së pari, ato rrisin efektin estetik të komunikimit. Imagjinata vizuale, ritmi dhe muzikaliteti, konciziteti letrar e humori, që vijnë si pasojë e përdorimit të tyre, bëjnë që fjalët të ëmbëlsojnë dëgjuesin.

Së dyti, shembëlltyrat janë thesar i kuptimit të fshehur dhe simbolikës, duke ofruar një mënyrë për të transmetuar koncepte të komplikua në një mënyrë të thjeshtë dhe të qasshme. Përdorimi i shembëlltyrës në një diskutim ose një fjalim, e fton dëgjuesin të hynë në një proces mendimi më të thellë, duke e bërë atë të përfshirë aktivisht në interpretimin e mesazhit.

Kjo jo vetëm që forcon lidhjen midis folësit dhe dëgjuesit, por gjithashtu rrit vlerën përvetësuese dhe mbamendëse të asaj që thuhet. Valët e ideve që ruhen në kujtesë, përhapen duke u zgjeruar dhe fitojnë terren në përshtypjen që lë fjalimi. Shembëlltyrat dhe elementët e ngjashëm stilistik në ligjërim, bën që folësi të duket më kompetent, kreativ dhe ndoshta edhe me autoritet si ligjërues që di të përdorë gjuhën, për të krijuar art.

Për më tepër, kjo teknikë e komunikimit me shembëlltyra ndihmon në tejkalimin e barrierave kulturore dhe gjuhësore, pasi ato prekin bazën universale të përvojës njerëzore. Shembëlltyrat letrare jo vetëm që ndikojnë, por janë thelbësore për të krijuar një efekt estetik në ligjërimin gojor, duke e bërë komunikimin më të gjallë, më elegant, më mbresëlënës. Në një botë ku fjalët shpesh bien në vesh të shurdhër, një shembëlltyrë e mirëzgjedhur mund të jetë kyçi që hap dyert e zemrës dhe mendjes në raportin e komunikimi gojor.

Fjalë çelës: *Shembëlltyrë, komunikim, efekt estetik, ligjërim gojor, koncizitet letrar*

THE AESTHETIC EFFECT OF LITERARY EXAMPLES IN ORAL DISCOURSE

Abstract

The use of literary similes, (parables), in oral discourse is not only an art, but also a kind of magic that transforms simple words into a plot of meaning and beauty. A small story that carries a deep message, such that it makes you think and feel like a discoverer of a great unknown. That's the power of simile! In the context of oral discourse, similes (and other stylistic figures) play a dual role.

First, they increase the aesthetic effect of communication. Visual imagination, rhythm and musicality, literary conciseness and humor, which they want to use, make the words sweet to hear.

Second, similes treasure hidden meaning and symbolism, starting with a way to convey complicated concepts in a way that is usable and accessible. The use of simile in a discussion or speech invites listeners to enter a deeper thought process, becoming actively involved in interpreting the messages. This not only for the connection between the speaker and the listener, but also increases their value of what is said. Waves of ideas that are stored in the memory, spreading by adapting to the ground in what we sleep. The metaphors and stylistic elements in the speech so that the speaker seems more competent, creative and can also be authoritative as a speaker who knows how to use language to create art.

Moreover, these linguistic communication techniques in overcoming earthly cultural barriers, as they touch the universal base of human knowledge. Literary similes not only are but have been found to create an aesthetic effect in oral discourse, making communication more lively and elegant, thinking and, above all, more. In a world where words often fall on deaf ears, a well-chosen parable can be the key that unlocks the doors of the heart and mind in the rapport of oral communication.

Key words: *Simile, communication, aesthetic effect, oral discourse, literary conciseness.*

Qëllimi

T'i njohim dhe të dimw të përdorim me efektivitet shembëlltyrat.

Shembëlltyra, nga vetë kuptimi terminologjik që ka fjala, është një figurë që realizohet në forma të letërsisë dhe arteve sinkretike, ku ka shkrirje të vlerave të rrëfimit, gojëtarisë, gjuhës, etikës dhe moralit, didaktikës dhe filozofisë së jetës.

Në situata ligjërimore funksionet e rrëfimeve qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë alegorik, realizohen përmes shembullit, ose shembëllzimit, që përbën kushtin themelor të shembëlltyrës. Shembulli që vjen gjatë ligjërimin, duhet të përmbajë një situatë, e cila përshkruhet bukur, perceptohet estetikisht, dhe përmban një përgjigje të vlefshme, një domethënie apo një ide të rëndësishme, ose një përfundim si definicion mbi precedentin e ndodhur. Ato janë arketipe të gatshme që ndërfiten në mes të rrjedhës ligjërimore, në mënyrë të natyrshme dhe kur është nevoja, për të qartësuar dhe zbukuruar ligjëratën situatën. Sinkronikisht dhe diakronikisht, vlen për të zgjidhur një problem të identifikuar dhe çfardo situatë të ngjashme me të.

Metodologjia

Në këtë artikull do të diskutohen teoritë kyçe nëpërmjet metodës së analizës dhe sintezës që na lejon që nëpërmjet gjetjeve teorike, të zbulojmë marrëdhënien midis stilistikës letrare dhe ligjërimin gojor dhe të konkludojmë mbi efektivitetin, nevojën dhe perspektivën e përdorimit të shembëlltyrave në pasurimin e sistemit komunikativ në situata ligjërimore.

Diskutimi

Shëmbëlltyra si përkufizim teorik

Shëmbëlltyra, nga vetë kuptimi terminologjik që ka fjala, është një figurë që realizohet në forma të letërsisë dhe arteve sinkretike, ku ka shkrirje të vlerave të rrëfimit, gojtarisë, gjuhës, etikës e moralit, didaktikës, filozofisë së jetës. Të gjitha funksionet e rrëfimeve alegorike popullore realizohen përmes shëmbëlltit, që përbën kushtin themelor të shëmbëlltyrës. Shëmbulli duhet të përmbajë një situatë, e cila përshkruhet bukur, perceptohet estetikisht, dhe përmban një përgjigje të vlefshme sinkronikisht e diakronikisht, vlen për të zgjidhur një problem të identifikuar dhe çfarëdo situatë të ngjashme me të. Të folurit me shëmbëlltyra është një veçori ligjërimore, një stil i veçantë i figurshëm. Me një strukturë gjuhësore koncize dhe me pak fjali paraqet kumtin dhe argumentin. Kur ligjërojmë shëmbëlltyra shfaqen në mënyrë specifike sipas fushave. Në lëtrësi filozofi moral etikë, religjion, komunikime politike biseda të lira etnografike apo folklorike.

Në të vërtetë, kumti vjen pas shëmbëlltyrës. Estetikisht, njerëzit i pranojnë shëmbëlltyrat si tregime të shkurtra, të këndshme, të bukura. E ngjashme me shëmbëlltyrën është **paravolia**, e cila është mjete bazë figurativ që përdoret në Kur'an dhe Bibël.

Të pafund janë shembujt, krahasimet, simbolet, që ndërtojnë sistemin alegorik që na tregon se shëmbëlltyra është një gjedhe e ardhur nga letërsia ungjillore dhe kur'anore dhe si e tillë burimet dhe origjina e saj duhen kërkuar pikërisht në ato kumte. Në ligjërimin publik, në rastet e tubimeve shëmbëlltyrat jepen dhe interpretohen gojtarisht. Ato shndërrohen në mesazhe të fuqishme në tribunat dhe katedrat ligjërimore apo edhe në takime sociale etnografike, duke i pasuruar me shëmbëlltyra.

Një ajet kur'anor thotë: “Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kur'an për çdo gjë, për t'ua vënë veshin.” Këtu parashkruhet në mënyrë mjaft të qartë funksioni i paravolisë, si shëmbull përngjasues. Në aspektin filozofik, retrospektiva që na sjell shëmbëlltyra gjatë ligjëritimit shërben për të thirrur perspektivën, pasi përbëjnë një retrospeksion, duke lidhur të kaluarën me të tashmen, të sotmen me të ardhmen.

Kështu në ligjërim, përmes shëmbëlltyrave letrare, si ilustrim dhe nevojë ngjashmërie, lexuesi dhe dëgjuesi fiton një përftesë kohore, shumëkuptimësi, kënaqësi estetike, ashtu si edhe paralelizëm figurativ në shkrimin letrar. Përdorimi i shëmbëlltyrave si metodologji ligjërimore janë një investim kulturor, për t'i dhënë komunikimit hijeshi dhe finesë, duke i përdorur ato në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

Estetikisht, njerëzit i pranojnë shëmbëlltyrat si tregime të shkurtra, të këndshme, të bukura. Ato janë kujtesë që shndërrohen në imazh dhe pastaj në kumt, në zë, në zërin tjetër që fle dhe zgjohet në thellësitë e njeriut. Ligjërimi me shëmbëlltyra, si rregull, nuk përftohet në një komunikim të rëndomtë, por në një komunikim solemn, që ka si kusht një audience-bashkësi, e cila nuk është asnjëherë në kontekst. Fuqia e audiencës është gjithëpranuese ndaj precedentit. Prania e audiencës i jep shëmbëlltyrës funksione kanonizuese.

Në shëmbëlltyrat ungjillore dhe kur'anore, janë të dy modelet: me porosi morale të drejtpërdrejtë dhe me porosi morale të nënkuptuar. Paravolia, parabola dhe shëmbëlltyra (si nënvariant i tyre tregimet alegorike) janë i njëjti term, por me burim të ndryshëm gjuhësor. Nuk ka ndonjë kufi të prerë mes tyre, por zakonisht nuk e zëvendësojnë njëra-tjetrën. Në shumicën e rasteve shëmbëlltyra mbyllet me nënkuptime. Shëmbëlltyra vë në provë urtësinë e rrëfyesit dhe të dëgjuesit. Gjithnjë ka një sekret, një kumt të kodifikuar, që rrëfyesi dhe audienca e ndajnë bashkë, nëse kanë urtësinë e mjaftueshme.

SHEMBËLLTYRA ËSHTË MJETI BAZË FIGURATIV QË PËRDORET NË LIGJËRIM IN GOJOR DHE LETRAR

Të pafund janë shembujt, krahasimet, simbolet, që ndërtojnë sistemin alegorik të Kur'anit që na tregon se shëmbëlltyra dhe paravolia janë një gjedhe e ardhur nga letërsia kur'anore dhe Biblws, si e tillë burimet dhe origjina e saj duhen kërkuar pikërisht në ato kumte.

Edhe tregimet kur'anore, në të gjitha rastet e tubimeve jepen dhe interpretohen gojarisht. Ato shndërrohen në mesazhe të fuqishme në foltore në ritet dhe festat fetare, duke i pasuruar me shëmbëlltyra.

Shëmbëlltyrat krijojnë në publik situata mjaft tërheqëse ligjërimore, me forcën e ideve, bukurinë artistike dhe aftësinë shprehëse të gjuhës.

Kur shëmbëlltyra hyn në fushën e alegorisë, ajo merr një kuptim më të thellë për ta përthithur, dhe më e vështirë për t'u kuptuar.

Në aspektin edukativ shëmbëlltyrat përcjellin mesazhe botëkuptimore dhe estetike, si nevojë njerëzore për disiplinë, frymëzim dhe energji.

Oratoria ligjërimore e pasuruar me shëmbëlltyra dhe episode mahnitëse dhe të ndërthurur bukur me metafora, hiperbola, metonimi dhe simbole, me krahasime dhe paralelizma që krijojnë ligjërim të këndshëm, i cili të rrëmben, ruhet në kujtesë, cilat të mbeten në mendje, të rrënjosen thellë në shpirt dhe të bëjnë të reflektosh thellë, duke u bërë më i vetëdijshëm, më human, më i sigurt.

Shëmbëlltyrat kur'anore janë një arsenal mjaft i pasur estetik, për të ndjerë dhe kuptuar atë që nuk e shikon, nuk e percepton apo nuk e kupton.

“Janë të pa numurta rrëfimet në botë”¹ shkruan Roland Bart (Barthes). Ndërsa Umberto Eko, duke konsideruar ritregimin si formë ligjërimore thotë: **“Nevoja për të komunikuar nëpërmjet ritregimit ka qenë një dukuri e kahershme e njerëzimit. Të tregosh dhe të dëgjosh tregime është një funksion biologjik. Nuk shkëputesh dot lehtë prej joshjes së intrigave në gjendjen e tyre të pastër. Çdo ligjëratë ka një strukturë të thellë, që është narrative ose që mund të jetë zhvilluar në terma narrativë”**.²

Do të mjaftonte vetëm veçimi i asaj dukurie gjuhësore-letrare si “e tashmja dëftore-urdhërore” apo “e ardhmja urdhërore”, që cilëson ligjërimin etno-juridik: “Kush të vjedhë gjënë e gjallë të kishës, ká me lá dý per një... (“Kanuni i Lekë Dukagjinit”)

Përfundimi

Rëndësia e shëmbëlltyrrave në komunikim

Rëndësia e përdorimit të shëmbëlltyrave jo vetëm në shkrim, por edhe në ligjërim. Do të bëhet një prezantim i qëllimeve të artikullit dhe pyetjeve kryesore që do të trajtohen.

Artikulli synon të analizojë rolin e stilistikës letrare në kontekstin e ligjërimit gojor, duke u fokusuar te shëmbëlltyrat letrare dhe duke vëzhguar, se si teknikat dhe elementët letrarë mund të aplikohen në komunikimin e përditshëm, për të arritur një thellësi dhe një nuancë të caktuar në marrjen e mesazhit. Përmes një analize ndërdisiplinore që mbështetet në të dhëna nga gjuhësia, psikologjia, dhe studimet letrare, ky artikull ofron një vështrim të detajuar mbi mënyrat në të cilat shëmbëlltyrat si element i stilistikës letrare ndikojnë në perceptimin, interpretimin dhe efektivitetin e komunikimit verbal.

Shëmbëlltyrat shërbejnë si një mjet i fuqishëm për të pasur një komunikim më të pasur, më të

1 Roland Bart (Barthes), Introduction a l'analyse structurale des recits (Communications 8, 1966, Milano, 7).

2 Umberto Eko, Për letërsinë.T. 2007, fq. 236.

imazhueshëm dhe më të thellë me audiencën. Përdorimi i tyre zgjeron fuqinë e shprehjes së fjalëve dhe krijojnë një imazh më të qartë dhe më të kuptueshme për dëgjuesit ose lexuesit, duke patur një impakt pozitiv në gjuhën dhe komunikimin njerëzor. Përdorimi i tyre bën të mundur që audiencës t'i japë një kuptim më të thellë dhe të përshtatshëm një ide, ndjesi, ose situatë. Estetikisht shembëlltyrat janë mjet i fuqishëm për të shprehur emocione dhe ndjenja të ndryshme. Në vend që të shprehim thjesht një emocion, përdorimi i shembëlltyrave e bën atë më të ndjeshme dhe më të qartë për audiencën.

Shembëlltyra që shfaq një imazh të fuqishëm ka më shumë mundësi të mbahet mend për një kohë më të gjatë krahasuar me një paraqitje të thjeshtë rrëfimore.

Shembëlltyrat na ndihmojnë në krijimin e lidhjeve emocionale me audiencën. Kur një person ndjen se komunikuesi është i njëjtë në emocione dhe ndjenja me të, komunikimi bëhet më efektiv dhe më i bindshëm. Krijimi i Bukurisë dhe Estetikës: Përdorimi i shembëlltyrave në poezi, prozë, muzikë dhe art edhe në Kur'an, në përgjithësi u jep një dimension të veçantë dhe të bukur këtyre veprave. Shembëlltyrat janë një mjet për të shprehur gjithë bukurinë dhe kompleksitetin e botës.

Në përfundim, shembëlltyrat janë një element i rëndësishëm i gjuhës dhe komunikimit njerëzor. Ata ndihmojnë të shprehim ide, emocione dhe imazhe në një mënyrë të fuqishme dhe të ndjenjshme. Përdorimi i shembëlltyrave me maturi dhe në kontekstin e duhur nxit lidhje më të thella me audiencën dhe krijojnë një komunikim më të pasur dhe të kuptueshëm. Në këtë mënyrë, shembëlltyrat i japin një pasuri e shtuar komunikimit tonë.

Të fshehtat shumëkuptimëshe që përmbajnë shembëlltyrat profetike dhe me ndikimin e tyre në mendësinë e njeriut përgjatë rrjedhave të kohëraveku njeriu i dha kompetencë mendjes së vet të përdorë modele ligjërimit si të profetëve, duke dëshmuar një lidhje shumë të hershme të kësaj tradite ligjërimore. Ashtu si masnavitë e Rumiut, edhe vjershat e rrëfenjat e Saadiut janë polisemantike, për shkak të fuqisë së shembëlltyrës, mbi bazën e së cilës janë ndërtuar. Apo te Kadare *Pallati i Ëndrrave*, ku parabola është elementi bazë i strukturës së romanit, "*Ferri*" i Dantes etj.

Konkluzion

Artikulli shkencor në temën e stilistikës letrare në ligjërimin gojor, hedhë dritë mbi rëndësinë e stilistikës letrare në kontekstin e ligjëritit gojor, duke eksploruar mënyrat në të cilat elementët e stilistikës letrare mund të përdoren për të pasuruar dhe thelluar komunikimin verbal. Përgjatë ligjëritit, shembëlltyra shkakton estetikisht një reaksion zinxhir të moralit, të kënaqësisë, nxit ndjenjë, përfytyrim, ndijim, perceptim.

Estetikisht, njerëzit i pranojnë shembëlltyrat si tregime të shkurtra, të këndshme, të bukura. Ato janë kujtesë që shndërrohen në imazh dhe pastaj në kumt, në zë, në zërin tjetër që fle dhe zgjohet në thellësitë e njeriut. Shembëlltyrat janë një arsenal mjaft i pasur estetik, për të ndjerë dhe kuptuar atë që nuk e shikon, nuk e percepton apo nuk e kupton.

Referencat:

1. Eko, Umberto: Mbi Letërsinë, Tiranë 2007.
2. Schiller, Friderich: Mbi edukimin estetik të njeriut, "Plejad", Tiranë 2004.
3. Kazim, Ebrahim: Ese mbi temat e Islamit.
4. Jeferson, Ann: Teoria letrare moderne, Albas, Tiranë 2006.
5. Grup autorësh: Zhvillimet në shkencat e ligjëritit dhe lënda e gjuhës dhe e letërsisë në arsimin parauniversitar, Botimet Albanologjike Tiranë, Nr. i faqeve: 524 Viti 2020

6. Shaban Sinani: Etnos në Epos, Shtëpia botuese: “Naimi” Tiranë, Viti: 2011, Fq. 240
7. Rugova, Ibrahim: Refuzim estetik: Rugova, Ibrahim; Pages: 367, Prishtinë 2005.
8. Akademia e Shkencave: Studime filologjike, nr. 1 dhe 2. Tiranë 2003.
9. Lakoff, G., & Johnson, M. Metaforat me të cilat jetojmë. Shtypi i Universitetit të Çikagos. 2020.
10. Forceville, C., & Urios-Aparisi, E. (Eds.). Metafora multimodale. Mouton de Gruyter. 2023.
11. Gibbs Jr, R. Ë. (2018). Manuali i Metaforës dhe Mendimit të Kembrixhit. Cambridge University Press.
12. Historia e Letërsisë Perse: Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë 2008.
13. Instituti Albanologjik i Prishtinës: Gjurmime albanologjike, Prishtinë 1989.
14. Instituti i Kontakteve Kulturore: Fjala, 2003, revistë kulturologjike.
15. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam: Univers, Tiranë 2005.
16. Kazim, Ebrahim: Ese mbi temat e Islamit.
17. Mevlana, Xhelaleddin, Rumi: Masnavi Ma’navi, Tiranë 2007.
18. Perla: Revistë kulturore shkencore, Tiranë 2007/4. ; 2005 /1.
19. Përmbledhje ligjërata, Prishtinë 2023, Nr. 2.